



Maylinde Zekaj
Prof.



Burim
Amila Canaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 1195 / Prot.

Vlorë më, 23.04.2025

VENDIM

Nr. 59 datë 29.04.2025

PËR

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE NË INXHINIERI ARMATIMI ME PROFIL MINOR NË
AVIACION DHE NAVAL" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, nenit 38, pika 1, shkronja dh, nenit 75 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar propozimit të Zëvendësrektorit Akademik ardhur me shkresën 1272/2 prot, datë 29.04.2025 Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 29.04.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore për hapjen e programit të përbashkët të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Armatimi me profil minor në Aviacion dhe Naval" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, Zëvendësrektorit Akademik, Sektori i Kurrikulave dhe Statistikave në UV.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet AKFAL.
4. Vendimi përcillet për miratim përfundimtar në MAS dhe QSHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ

A. Saliaj